



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2018, ora 10:15

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Pjerin Ndreu dhe Ismet Beqiraj.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Sajmir Muçmataj – përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Arvid Uruçi – përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit. Sot në rendin e ditës kemi vetëm një çështje, projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë””, që ndryshohet për herë të parë. Për ta prezantuar projektligjin në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave ndodhen zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zoti Elton Haxhi. Relatore e komisionit për këtë projektligj është zonja Blerina Gjylameti.

Fillojmë menjëherë me prezantimin e projektligjit nga ana e zëvendësministrit dhe më pas do të procedojmë normalisht me projektligjin.

Urdhëroni, zoti Haxhi!

Elton Haxhi – Faleminderit!

Sot para jush kemi sjellë për miratim një ndryshim në ligjin nr. 55 të vitit 2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Ndryshimi konsiston në një zgjatje të afatit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për fitimin e statusit “investitor strategjik”, procedurë e veçantë e asistuar. Ligjit i mbarojnë efektet e tij më 31.12.2018, prandaj kërkohet një zgjatje e këtij afati deri më 31.12.2019. Aktualisht, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me asistencën e IFC-së është duke punuar për një ligj të ri për investimet, i cili do të unifikojë dy ligje, ligjin aktual që kemi sjellë për zgjatje afati për investitorët strategjikë dhe ligjin për mbrojtjen e investitorëve të huaj.

Duke qenë se jemi duke përgatitur ligjin e ri dhe parashikimet janë që ky ligj të përfundojë dhe të sillet për miratim në vitin 2019, gjysmën e parë të vitit, në vazhdimësi do të sjellim edhe ligjin tjetër për mbrojtjen e investitorëve të huaj për zgjatje afati, sepse edhe këtij ligji i përfundojnë afatet në 31.12.2018. Aktualisht kemi këtë ligj për zgjatjen e efekteve të tij me një vit dhe në vazhdimësi do të sjellim edhe ligjin tjetër.

Pra, ky ligj do të zgjatet edhe për një vit, ndërkohë që ne jemi duke punuar me një ligj të ri për investimet e huaja dhe vendase, i cili do të harmonizojë dhe do të sjellë disa risi në rritjen e besimit të investitorëve, duke parashikuar edhe një mekanizëm, i cili është kërkuar nga investitorët, për shqyrtimin e pabarazisë në trajtimin e tyre nga një institucion, i cili është jashtë

procesit gjyqësor, një shqyrtim i ankesave të tyre përpara kalimit në një proces të rregullt gjyqësor.

Pak a shumë ndryshimi ka të bëjë vetëm me ndryshimin e datës, por në qoftë se ju keni i pyetje jam i gatshëm t’u përgjigjem.

Faleminderit!

Erion Braçe – Fjalën e ka zonja Gjylameti, si relatore e komisionit.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Projektligji që po shqyrtojmë sot është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe plotëson kriteret e nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Përmes këtij projektligji propozohet një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ligj, i cili ka në fokus nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike vendase dhe të huaja në sektorët strategjikë si ai energjetik, minerar, i transportit, infrastrukturës, komunikimeve elektronike, mbetjeve urbane, turizmit, bujqësisë, peshkimit, zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, si dhe zonave me përparësi zhvillimin.

Nëpërmjet këtij ligji janë vendosur procedura të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese me qëllim mbështetjen e shërbimeve ndaj investitorëve.

Dua të vë theksin në faktin se ishte pikërisht ky ligj i vitit 2015, i cili, bazuar në parimin e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, mundësoi përmes një kuadri të plotë ligjor mbrojtje të njëjtë si për investimet e huaja, ashtu edhe për investimet vendase, të cilat më parë nuk ishin të mbrojtura njëjloj.

Projektligji parashikon ndryshimin e nenit 36, të ligjit nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” duke shtyrë afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedura për përfitimin e statusit “Investitor strategjik”, procedurë e asistuar, e veçantë nga 31 dhjetori 2018 deri më 31 dhjetor 2019.

Zgjatja e këtij afati ka për qëllim mundësimin e përfitimeve nga lehtësirat që ofron ky ligj për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë edhe për një vit tjetër për të gjithë investitorët vendas ose të huaj.

Projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit. Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve “AIDA”, Komiteti i Investimeve Strategjike, si dhe të gjitha institucionet dhe organet e administratës shtetërore që kanë në fushën e kompetencave të tyre elemente specifike procedurale.

Në përfundim të fjalës sime, duke vlerësuar se përmes këtij projektligji u jepet një mundësi e shtuar investitorëve vendas dhe të huaj për të investuar në këta sektorë strategjikë, i propozoj komisionit miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Ka pyetje?

Blerina Gjylameti - Do të doja të bëja një pyetje, thjesht teknike, duke dashur që të qartësohet edhe një herë nga zëvendësministri: realisht 31 dhjetori 2019 është afat i mjaftueshëm, apo sikundër ju përmendët në fjalën tuaj për një nga projektligjet, apo një nga ligjet e tjera për investimet strategjike, do ta shikonit si mundësi tjetër shtyrjeje?

Elton Haxhi – Puna ka filluar me hartimin e këtij ligji të ri për investimet, i cili do të unifikojë dy ligje, ligjin aktual nr. 55 dhe ligjin nr. 7764 “Për investimet e huaja”.

Duke marrë parasysh edhe komentet nga Komuniteti i Biznesit, është organizuar një tryezë në muajin maj, po punohet me IFC-në, dhe, sipas planit, mendohet që ligji i ri do të përfundojë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 dhe do të ketë efekt nga 1 janar 2020.

Blerina Gjylameti - Kryetar, kisha edhe një kërkesë. Mendoj se është shumë e rëndësishme që Ministria e Financave të na dërgojë një material të plotë, pra një raport për të gjitha investimet strategjike, që janë pjesë e këtij ligji që ka hyrë në fuqi. Pra, çfarë ka pasur si ndryshime nga momenti i hyrjes në fuqi deri më sot?

Erion Braçe – Unë kisha një pyetje: cila ka qenë efienca e këtij ligji?

Është përdorur, sa është përdorur? Çfarë investimesh strategjike kemi përfituar, që janë trajtuar përmes këtij ligji? Cilat kanë qenë investimet e huaja të mbrojtura nga ligji që është në fuqi dhe që do t’u shtyhet afati, e kështu me radhë, në rast se e keni një informacion të tillë?

Blerina Gjylameti - Në vazhdimësi, pyetja ime nëse do të vinit për herë të dytë për të kërkuar shtyrje të afatit lidhet edhe me këtë: sot që flasim, a kemi kërkesa apo procedura që janë në vazhdim dhe a do të përfundojnë këto brenda vitit 2019? Pra, cila është shtysa për të ndryshuar afatin?

Elton Haxhi – Në lidhje me ligjin nr. 55, për një inventar ose një listë të investitorëve që kanë përfituar, do t'ju sjellim një listë, e cila u referohet të gjitha vendimeve që ka marrë Këshilli i Investimeve Strategjike, që merr vendime në lidhje me dhënien e statusit.

Do të mundohemi t'ju japim një informacion në lidhje me kërkesat në shqyrtim ose atyre që janë ende në fillesat e tyre.

Ligji i ri mendohet që do të ketë një mekanizëm, cili do të trajtojë investitorët strategjikë. Edhe nëse procedura nuk përfundon deri në skadimin e ligjit që po diskutojmë sot, besoj se edhe ligji i ri do të ketë një trajtim për investitorët e kësaj kategorie.

Blerina Gjylameti - Për mua është shumë e rëndësishme që kjo listë të na vihet në dispozicion brenda ditës së nesërme, pra para seancës së radhës, në të cilën do të shqyrtohet ky projektligj.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje të gjithëve!

Në vazhdim të shqetësimit dhe pyetjeve që bëri zonja Blerina, kam dy pyetje që kanë të bëjnë, së pari ka të bëjë me rehabilitimin e zonave të ndotura nga industria e naftës, sepse bëhen investime në infrastrukturë, por për rehabilitimin e këtyre zonave asnjëherë nuk është diskutuar. A do të parashikohen tek investimet strategjike?

Së dyti, në të gjithë Shqipërinë janë gati 600 ujëmbledhës për vaditje. Unë marr rastin konkret, në zonën ku unë jam deputet, Mallakastër, janë 18 ujëmbledhës, por të gjithë janë jashtë pune. A përfshihen në listën e investimeve strategjike? Nëse nuk janë përfshirë, le të futen, sepse po jepen grante për zhvillimin e bujqësisë, por, nëse nuk ka ujë për vaditje, investimet që ndërmerren janë të dështuara.

Elton Haxhi - Ligji për investimet strategjike ose për investitorët e huaj, me sa kuptoj, po i referoheni një sektori, i cili trajtohet nga investime publike trajtojnë investitorët privatë dhe, nëse do të ketë kërkesë nga një investitor privat për një aktivitet në fushën naftëmbajtëse ose të mbledhësve ujorë, kjo do të trajtohet në kuadër të kritereve që kanë ligjet e parashikuara, por kryesisht trajtojnë investime private, të cilat mund të jenë në fusha të ndryshme të sektorëve prioritarë.

Po i referohem pyetjes së parë, e cila ka lidhje me kontratat e hidrokarbureve, pra çfarë përmban një kontratë për shfrytëzimin e burimeve natyrore në fushën naftëmbajtëse dhe pjesa tjetër ka lidhje me grantet për bujqësinë.

Ismet Beqiraj- Ju lutem, për një sqarim, kur kërkoja rehabilitimin e zonave të ndotura nga industria e naftës, nuk kam parasysh kontratat e reja hidrokarbure ose ato që janë në veprim, qoftë koncesionaret, qoftë kompania publike, por kam parasysh ndotjet mbetëse historike pranë shtretërve të lumenjve të tokave të helmuara në zonat e banuara. A do të bëjmë sehir?

Elton Haxhi – Ligji për investimet strategjike konsiston në kërkesa nga investitorët për një investim në një masë të caktuar, pra ka disa kriteret që duhen plotësuar në punësim dhe në sektorët prioritarë të ekonomisë.

Çështja që ju kërkon të trajtohet në këtë projektligj nuk është pjesë e trajtimit në këtë ligj. Ne nuk mund të kërkojmë që të marrim kërkesa në një fushë të caktuar. Nëse do të ketë një investitor, i cili do të kërkojë të trajtojë mbetjet në zonat naftëmbajtëse ose përpunuese të naftës, do të trajtohet duke u bazuar në kriteret që ka ligji, e kam fjalën për statusin e investitorit strategjik.

Nuk jam i sigurt nëse ka pasur ndonjë kërkesë në këtë lloj aktiviteti, megjithatë, kur t’jua sjellin këtë informacion, do ta shikojmë nëse ka një kërkesë në atë fushë.

Erion Braçe - A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1 që ndryshon afatin nga data 31 dhjetor 2018 deri në datën 31 dhjetor 2019. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Zëvendësministër, brenda ditës së nesërme të vijë informacioni i kërkuar nga zonja Gjylameti në Komisionin e Ekonomisë.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

MBYLLET MBLEDHJA